



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 324/17 Prot.

Pogradec, më 22 . 02 . 2026

VENDIM

Nr. 03 , Datë 29 . 01 2026

PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË FAMILJEVE NË NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN ME FONDIN DERI NË 6% NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE PËR VITIN 2026.

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1, shkronja (a) dhe (b), nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; nenit 21 të ligjit nr.57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", vendimit nr.597, datë 4.09.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", ndryshuar me Vendimin nr.855, datë 26.12.2024 :

**KËSHILLI I BASHKIAK
VENDOSI:**

1. Të miratojë kriteret mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% ose me fondet e buxhetit vendor, për vitin 2026.
2. Përfituesit nga fondi 6% i bllok-ndihmës ekonomike do të përzgjidhen nga familjet aplikuese për ndihmë ekonomike të cilat janë refuzuar nga sistemi elektronik i ndihmës ekonomike pasi kanë marrë pikë të pamjaftueshme, pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme për të jetuar dhe plotësojnë këto kriterë:
 - 2.1 Të përfitojnë familjet që refuzohen nga sistemi për pikë të pamjaftueshme, me nevoja sociale të theksuara dhe nuk kanë asnjë anëtar të punësuar.
 - 2.2 Kryefamiljaret gra, të cilat refuzohen nga sistemi për pikë të pamjaftueshme .
 - 2.3 Te moshuarit të mbetur vetëm që janë në varfëri ekstreme dhe refuzohen nga sistemi për pikë të pamjaftueshme .

¹Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com



- 2.4 Beqarët të ngelur vetëm , në moshë mbi 40 vjet , të pamundur për të punuar të cilët janë refuzuar nga sistemi elektronik i ndihmës ekonomike për pikë të pamjaftueshme, pa të ardhura,
- 2.5.Familje që kanë në përbërje të tyre persona me aftësi të kufizuar , refuzuar nga sistemi për pikë të pamjaftueshme dhe nuk kanë asnjë të punësuar.
- 2.6.Familjarë në prag pensioni që nuk kanë mundësi punësimi dhe janë refuzuar nga sistemi për pikë të pamjaftueshme.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes.

KRYETARE E KËSHILLI
Manjola KAMOLLI



1.Miratuar me 23 **vota**

2.Vota Pro 23

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 0

5.Zbardhur më date 29.01.2026